

KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Sot më datë 31.01.2024 në Tiranë në shoqërinë "AMAR EXCHANGE" Shpk me NIPT M32422029U ndodh shit-blerja e kuotave si më poshtë:

- **Z. Sefulla Telhallari**, shtetas shqiptar, lindur më 17.03.1959, në Prrenjas dhe banues në Tiranë me numër identiteti F90317039R, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, ortak me 50,00 % të kuotave të shoqërisë «AMAR EXCHANGE » shpk me NIPT M32422029U (nga këtu e më poshtë referuar si shitësi) :

Dhe

Z. Albi Telhallari, shtetas shqiptar, lindur më 15.12.1992, në Tiranë dhe banues në Tiranë me numër identiteti J21215041P, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, ortak me 50,00 % të kuotave të shoqërisë «AMAR EXCHANGE » shpk me NIPT M32422029U (nga këtu e më poshtë referuar si blerësi) :

Të sipërpërmendurit, bazuar në nenin 73/1/b të ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nenin 705 dhe vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" dhe statutin e shoqërisë "AMAR EXCHANGE" SHPK, bien dakord si më poshtë:

NENI 1

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është shitja dhe transferimi i kuotës në pronësi të shitësit në shoqëri, te blerësi, në përputhje me parashikimet e mëposhtme. Me kalimin e pronësisë së kuotës në shitje në pronësi të blerësit, blerësi do të zotërojë një kuotë të shoqërisë që përbën 100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të saj me vlerë të përgjithshme 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë.

NENI 2

Cmimi i blerjes së kuotës, mënyra e pagesës dhe kalimi i pronësisë

Cmimi i kuotës në shitje që do të paguhet nga blerësi është 1.250.000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë) lekë. Blerësi do t'i paguajë cmimin e blerjes shitësit në datën e nëshkrimit të kësaj kontrate. Pronësia mbi kuotën në shitje do të kalojë në momentin e nëshkrimit të kësaj kontrate.

NENI 3

Deklarimet e garancitë e shitësit

Shitësi gëzon të gjitha të drejtat dhe aftësinë ligjore për të lidhur këtë kontratë dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj kontrate. Kuota në shitje në pronësi të shitësit përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të shoqërisë. Shitësi garanton që kuota në shitje sipas kësaj kontrate nuk është rënduar me barra të ndryshme ligjore (barrë siguruese/peng apo ndonjë formë tjetër barre ligjore) në favor të palëve të treta, private apo shtetërore.

NENI 4

Deklarimet e blerësit

Blerësi gëzon të gjithë të drejtat dhe aftësinë ligjore për të lidhur këtë kontratë dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj kontrate. Blerësi pranon se përpara nënshkrimit të kontratës i është dhënë mundësi e plotë për të marrë informacionin e nevojshëm në lidhje me shoqërinë në mënyre që të marrë një vendim të informuar në lidhje me këtë transaksion. Blerësi ka paguar cmimin e blerjes sipas mënyres së përcaktuar në kontratë.

NENI 5

Dëmshperblimi

Në rast se cmimi i blerjes nuk kreditohet në favor të shitësit sipas parashikimeve të Nenit 2.2, kjo kontratë konsiderohet e zgjidhur automatikisht dhe nuk krijon asnjë pasojë ligjore për palët të cilat do të kthehen në gjendjen e mëparshme.

Në rast se blerësi nuk përmbush detyrimet e tij në këtë kontratë dhe/ose shkel deklaratimet dhe garancitë e dhëna në Nenin 4 dhe 5, atëherë shitësi ka të drejtë të zgjidhë kontratën dhe të kërkojë cdo humbje apo dëmshperblim tjetër si pasojë e mospërmbushjeve apo shkeljeve të blerësit.

Në rast se shitësi nuk përmbush detyrimet e tij në këtë kontratë dhe/ose shkel deklaratimet dhe garancitë e dhëna në Nenin 3, atëherë blerësi ka të drejtë të zgjidhë kontratën dhe të kërkojë cdo humbje apo dëmshperblim tjetër si pasojë e mospërmbushjeve apo shkeljeve të shitësit.

NENI 6

Kosto

Cdo tarifë, takse ose tatim që duhet paguar nëse ka të tillë si rezultat i nënshkrimit të kësaj kontrate dhe i kalimit të kuotes në shitje, merret përsipër nga pala që është e detyruar me ligj dhe në rast se ligji nuk përcakton se kujt pale i ngarkohen, ato ndahen në mënyrë të barabartë midis palëve.

NENI 7

Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë dhe marrëdhëniet midis palëve do të rregullohen nga legjislacioni shqiptar dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare. Cdo mosmarrëveshje që lind nga/ose në lidhje me këtë kontratë përsa i përket zbatueshmërisë ose vlefshmërisë do të zgjidhet përfundimit nga gjykata kompetente shqiptare.

NENI 8

Gjuha, kopjet e kontratës dhe hyrja në fuqi.

Kjo kontratë hartohet në 2 kopje në gjuhën shqipe, secila prej tyre do të konsiderohet origjinale, por të gjitha bashkë do të përbëjnë një dhe të njëjtën marrëveshje.

Tiranë, 31 Janar 2024

PALËT:

SHITËSI

BLERËSI

SEFULLA TELHALLARI

ALBI TELHALLARI

